

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" Hasa-Gas COMPANY" SHPK

Sot me daten 03.02.2021 (dymijë e njëzet e një), unë ortaku themelues :

- **I. Z.Ylli Hasa**, I biri i Jonuz, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 21 Shkurt 1969, lindur në Sukth,Durrës dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë Identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte 032139375 dhe Nr.personal G90221010S.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* "Hasa-Gas COMPANY" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet "Hasa-Gas COMPANY" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Lagja nr. 7, Rruga V. Mici, Objekt me nr. pasurie 15/42-ND1, Zona Kadastrale 8512,Durrës.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

- kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti: Importi Importi – eksporti, depozitimi, tregtimi, transformimi, transporti i gazit te lengshem te naftes (GLN), gazit 2 propan, gazit metan, pjeseve perberese ose perzieresve te tyre si dhe te gjitha llojeve te tjera te gazrave teknike per perdorim industrial dhe civil. Importi – eksporti, shitja e bombolave te gazit te te gjitha dimensioneve dhe per te gjitha perdorimet. Tregtimi dhe rimbushja e bombolave te gazit. Importi-eksporti, shitja me shumice i karburanteve dhe produkteve derivate te tyre si nafta, benzina, karburanti i perdorur ne aviacion, vajra, lubrifikant, solari, etj perfshire dhe biokarburantet dhe nenproduktet e ketyre te fundit. Shoqëria mund te zhvilloje gjithashtu çdo aktivitet tjetër plotësues e ndihmës që rezulton i dobishme dhe/ose i nevojshëm për përmbushjen e objektit kryesor, duke përfshirë tregtimin e produkteve dhe kryerjen e shërbimeve të tjera.



NENI 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "**Hasa-Gas COMPANY**" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, secila me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

1.YLLI HASA, zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.YLLI HASA** i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.



Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË
"Hasa-Gas COMPANY" SH.P.K

YLLI HASA

Ylli Hasa

[Signature]